



P Z A P  
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.60/2025

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të mbajtjes së tubimeve publike, për qëllime elektorale të për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.01.2025, mori këtë:

#### VE N D I M

REFUZOHEȚ e pabazuar ankesa A.nr.60/2025 e datës 17.01.2025, parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të mbajtjes së tubimeve publike, për qëllime elektorale, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025.

#### A r s y e t i m

Me datë 17.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK, në të cilën theksohet se me date 15.01.2025 në ora 17:00 është mbajtur tubimi i subjektit politik LVV, në qytetin e Fushë Kosovës, ku në këtë tubim subjekti LVV ka bere shkelje të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës se Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, respektivisht nenit 4 paragrafit 2 i cili shprehimisht thotë: *Subjektet politike të certifikuara, mund të mbajnë tubimet në hapësirat publike, në institucionet arsimore, sportive dhe kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre dhe pasi që kjo të lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ.* Po ashtu parashtruesi i ankesës thekson se në rastin konkret në Palestrën e Sportit të SHFMU "Mihajl Grameno" në ora 17:00, është mbajtur tubimi, pra është penguar procesi i rregullt mësimor, ngase orari i punës së SHFMU përfundon në ora 18:20, dhe lidhur me këtë ka bashkangjitur si provë njoftimet zyrtare të këtij subjekti për mbajtjen e tubimit dhe orarin e SHFMU "Mihajl Grameno".

Më datë 18.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 19.01.2025 në ora 12:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 19.01.2025, të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, theksohet se me datë 15 janar është mbajtur tubimi i Lëvizjes Vetëvendosje, në komunën e Fushë Kosovës, dhe përkundër se konsiderojmë se nuk ka qenë detyrim i joni të kujdesemi përvendimet që i përkasin të drejtës publike, për hir të së vërtetës duam të paraqesim pretendimet tonë, se subjekti politik LDK ashtu siç shihet edhe në provat e bashkangjitura, nuk ka arritur të dëshmojë se një tubim i tillë është mbajtur në kohën siç ata e kanë përmendur orën 17:00, por vetëm kanë bashkangjitur njoftimet lidhur me mbajtjen e tubimit, çka nëasnje mënyrë nuk vërteton se një tubim i tillë është mbajtur, aq më pak se ka penguar procesin mësimor dhe aq edhe më pak se është mbajtur në hapësirat ku mbahet mësimi, pasi që nga njoftimi del se i njëjti është planifikuar të mbahet në sallën e sporteve të shkollës "Mihal Grameno", me çka me siguri se por pa dashur të paragjykojmë ka qenë edhe arsyesa se jemi pajisur si subjekt me leje përkatëse për këtë tubim. Përgjiges në ankesë i është bashkangjitur ne cilësinë e provës shkresa e miratimi i kërkesës nga ana e KKZ.

PZAP i, është drejtuar për përgjigje në ankesë edhe KQZ-KKZ në Fushë Kosovë, dhe në përgjigje theksohet se sipas paragrafit 2 nenit 4 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar, subjektet politike të certifikuara mund të mbajnë tubime në hapësirat publike, në institucionet arsimore, sportive dhe kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre, dhe pasi që kjo të lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ. Në përgjigje nga KQZ po ashtu sipas paragrafit 3 të nenit 4 të kësaj të Rregullores Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, subjekti politik që dëshiron të organizojë një tubim politik, duhet ta dorëzojë formularin për njoftim për tubim në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), jo më vonë se njëzetë e katër (24) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më pak se dyqind (200) pjesëmarrës dhe jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më shumë se dyqind (200) pjesëmarrës, dhe lidhur më këtë nga informacioni i pranuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në Komunën e Fushë Kosovës, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ka dorëzuar sipas afatit të parapare me Rregulloren Nr.07/2024, formularin për njoftimin e tubimit politik, për tubimin e datës 15 Janar 2025, në Palestrën sportive të SHFMU "Mihajl Grameno", në Fushë Kosovë, në ora 17:00, bashkangjitur në përgjigjen e KQZ-së, është edhe kopja e formularit të njoftimit për mbajtjen e tubimit politik.

Paneli, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

### **Ankesë është e pabazuar**

Bazuar në nenin 4 paragrafi 2 të Rregullores 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, e cila shprehimisht përcakton "Subjektet politike të certifikuara mund të mbajnë tubime në hapësirat publike, në institucionet arsimore, sportive dhe kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre dhe pasi që kjo të lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ".

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se bazuar në Rregulloren Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe

Deklarimin Financiar, neni 4 paragrafi 3 thekson se: se subjekti politik që dëshiron të organizojë një tubim politik, duhet ta dorëzojë formularin për njoftim për tubim në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), jo më vonë se njëzetë e katër (24) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më pak se dyqind (200) pjesëmarrës dhe jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më shumë se dyqind (200) pjesëmarrës, ndërsa nën paragrafi 4 thekson se : KKZ pas pranimit të formularit nga subjekti politik e regjistrion në libër të protokollit dhe vendos për miratim sipas datës dhe kohë së pranimit të njoftimit". KKZ jo më vonë se ora 09:00 në ditën e tubimit e njofton policinë dhe zyrën për qëllime të monitorimit".

Paneli bazuar në informacionin e pranuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në Komunën e Fushë Kosovës, nga formulari i bashkangjitur në përgjigje të KKZ-KQZ, vërtetohet se subjekti politik LVV, ka dorëzuar formularin për njoftimin për mbajtjen e tubimit politik me datën 9 Janar 2025, për mbajtjen e tubimit politik në Palestrën sportive " Mihajl Grameno", në Fushë Kosovë, në ora 17:00, dhe mbi këtë arsyе Paneli ka gjetur se subjekti politik LVV në fjalë ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura, pasi që është vërtetuar se subjekti politik në fjalë përvçe që ka marrë leje, përkatësisht e ka njoftuar Komisionin Komunal të Zgjedhjeve i njëjtë me tubimin e mbajtur nuk e ka penguar punën e rregullt të institucionit në fjalë .

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoi se pretendimet e palës ankuese se me mbajtjen e tubimit është penguar procesi i rregullt mësimor, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi, për faktin se subjekti politik LVV, lidhur me mbajtjen e tubimit politik me datë 15.01.2025, ka dorëzuar formularin për njoftim për mbajtjen e këtij tubimi në KKZ-KQZ, për të cilin tubim i është miratuar kërkesa nga ana e KKZ-KQZ, andaj nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.60/2025 më datën 20.01.2025

Kryesues i Panelit  
Arsim Hamzaj



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.